

Më:  
Data:

31.10.2017

PKR.nr.72/16

NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME**

**TË RËNDA**, gjykatë e shkallës së parë penale, me trupin gjykues në përbërje me gjyqtaren Hysnije Gashi kryetare e trupit gjykues dhe me gjyqtarët profesionistë Ilir Bytyqi dhe Faton Ajvazi, anëtar, si dhe me sekretaren juridike Albana Ujupi, në lëndën penale kundër të akuzuarit [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale përdorimi i paautorizuar i pasurisë nga neni 427 të KPRK-së të KPK-ës, duke vepruar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj PP/L.nr. 132/15 të datës 30 mars 2016, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Rasim Maloku, të akuzuarit me mbrojtësit e tij me autorizim Av. [REDAKTUAR], pas mbajtjes së shqyrtimit të hapur gjyqësor me datat 03.08.2016, 15.11.2016, 22.12.2016, 18.01.2017, 09.03.2017, 08.05.2017, 17.05.2017, 22.05.2017 morri dhe publikisht shpall dhe me datë 28.06.2017 përpiloi këtë:

**AKT GJYKIM**

I akuzuari [REDAKTUAR], nga i ati [REDAKTUAR] dhe e ëma [REDAKTUAR] e gjinisë [REDAKTUAR], i lindur më [REDAKTUAR] në [REDAKTUAR], Komuna e [REDAKTUAR], me vendbanim në të njëjtin vend, i martuar babë i tre fëmijëve, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjendjes së mesme ekonomike.

**Në bazë të nenit 390 par. 1 nën par. 3 të KPPK-së.**

**LIROHET NGA AKUZA**

Sepse natën e 26-27 Janar 2015, në intervalin kohorë 20-08 në Shtime, si person zyrtarë-hetues në stacionin policor në Shtime, pa autorizim ka përdorur pasurinë e luajtshme që iu është besuar për shkak të detyrës, në atë mënyrë që deri sa ka qene në detyrë zyrtarë në zbatimin e një plani operativ me veturën zyrtarë të markës "Golf 5" me targa [REDAKTUAR], në pikën e karburanteve "[REDAKTUAR]" që gjendet në rrugën magjistrale, Shtime-Lipjan ka marrë një faturë fiktive me numër serik 510112, të datës 27 Janar 2015, se kinse është

mbushur me 55 litra derivate te naftës vetura zyrtare e policisë e markës Golf 5 me targa

- meqë me asnjë provë nuk është vërtetuar se ka kryer veprën penale përdorim i pa autorizuar i pasurisë nga neni 427 te KPRK-së.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

## Arsyetimi

### 1. Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore ne Ferizaj, ka paraqitur aktakuzën PP/I.nr. 132/2015 të datës 30.03.2016, ndaj të akuzuarit [REDAKTUAR], për shkak të veprës penale përdorim i pa autorizuar i pasurisë nga neni 427 te KPRK-së.

Gjykata Themelore në Ferizaj duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datat 03.08.2016, 15.11.2016, 22.12.2016, 18.01.2017,09.03.2017, 08.05.2017,17.05.2017, 22.05.2017 kurse Prokurori i Shtetit Rasim Maloku, në fjalën përfundimtare ka mbetur pranë akuzës dhe i ka propozuar Gjykatës, që i akuzuari të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet dënimi i paraparë me ligj.

### 2. Mbrojtja e të akuzuarit

I akuzuari [REDAKTUAR], në fillim e deri përfundim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale përdorim i pa autorizuar i pasurisë nga neni 427 te KPRK-së. dhe më tutje ka sqaruar se i kujtohet data 26 dhe 27 janar 2015 ku ka qene ne detyrë se bashku me kolegun e tij [REDAKTUAR] dhe ka vozitur automjetin "Golf 5" me targa [REDAKTUAR] e cila veture ishte ne posedim te Njesisë se Hetimeve ne Stacionin policor ne Shtime , vetura ka qene e njesisë rajonale te hetimeve ne Ferizaj e qe te njëjtën e kane marre në huazim për plan operativ, me tej ka shtuar se ditën kritike ka shkuar ne pompën e derivateve "Ibrahimi Petrol" dhe e ka mbushur automjetin me derivatet e naftës , në pompe ka punuar punëtori Sali Bajrami dhe i njëjti pasi qe e kishte furnizuar me nafte ja ka plotësuar dhe vulosur faktuarën, me tej ka shtuar se pas 4-5 dite e ka thirrur komandanti i Stacionit Policor Enver Avdyli ku e kishte njoftuar se ne frakturë është bere një gabim ashtu qe i akuzuari [REDAKTUAR] te nesërmen ka shkuar ne pompën e benzinës se bashku me kolegun e tij

██████████ e që ne ndërrim ka qene duke punuar ██████████ i vëllai i ██████████ i cili pasi qe është njoftuar per gabimet ne frakturë e kishte thirre ne telefon pronarin e pompës se benzinës ██████████ "██████████" i cili pas bisedës në telefon i ka thanë që ta përmirëson faktuarën ashtu që të Ilmiu e kishte përmirësuar dhe vulosur frakturën, po ashtu ka deklaruar se është e vërtetë se dëshmitari Sali Bajrami kishte shkuar në shtëpinë e tij dhe i kishte kërkuar falje per çka i akuzuari e kishte udhëzuar që të shkoj në Prokurori apo Gjykatë për tu deklaruar.

### 3. Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Pasi që i akuzuari nuk ka pranuar fajësinë sipas kësaj akuze, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njëri me tjetrin, në kuptim të dispozitës së nenit 387 par. 1 dhe 2 të KPPK-ës, vërtetoj gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet të akuzuarit;

- nga dëgjimi i dëshmitareve , ██████████ , ██████████ , ██████████ dhe ██████████

- nga dëgjimi i ekspertit ██████████

- shikimi në faturën nr. 510112 të datës 27.01.2015 lëshuar nga ndërmarrja "██████████" në ██████████

- shikimi i raportit të policisë së Kosovës Departamenti i TIK-ut në Prishtinë për lëvizjet e veturës "Golf" me targa 05- 215-AN për datat 06, 21, 26, 27, dhe 29 2015 nga shikimi në CD me video incizim për lëvizjen e veturës "Golf" me targa 05- 215-AN për datat 26 dhe 27 janar 2015

- shikimi në imazhet fotografike të nxjerra nga video incizimi për lëvizjet e veturës për datën 06.21.dhe 29 janar 2015

#### **4.Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor**

Gjykata vlerëson të pakontestueshme dhe të provuara faktet dhe rrethanat e mëposhtme:

Se me datë 26-27 janar 2015 vetura Golf 5 te cilën e ka drejtuar polici [REDAKTUAR] është furnizuar me derivate të naftës

- se dëshmitari [REDAKTUAR] ka qenë duke punuar në pompën e benzinës [REDAKTUAR] e cila gjendet në afërsi të fshatit [REDAKTUAR]-[REDAKTUAR]

Pra, Gjykata ka pasur për detyrë që të ndriçoj në këtë çështje penale dy versionet e paraqitura si në procedurën hetimore, shqyrtimin e mëparshëm gjyqësor e po ashtu edhe në këtë shqyrtim gjyqësor dhe atë versionin e Prokurorit të Shtetit (se vepra penale është kryer nga i akuzuari) dhe versionin e akuzuarit dhe mbrojtësit të tij (se i akuzuari nuk e ka kryer këtë veprë penale), andaj Gjykata e ndodhur mes këtyre dy versioneve tërë arsyetimin e këtij aktgjykimi do ta përqendron pikërisht në sqarimin e këtyre rrethanave.

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit [REDAKTUAR] vërtetohet se me datën 26,27 janar 2015 ka punuar në cilësinë e punëtorit në pompën e benzinës "[REDAKTUAR]" në [REDAKTUAR] i kujtohet se të njëjtën ditë kishte shkuar polici [REDAKTUAR] së bashku me kolegun e tij polic me automjetin zyrtar të policisë Golf 5 ku i njëjti e kishte furnizuar me naftë diku rreth 45-50, litra dhe për këtë i kishte lëshuar faturë, me të cilën ka deklaruar se ishte njoftuar nga vëllai i tij [REDAKTUAR] se në faturën e datës 26,27 janar kishte bërë një gabim dhe të njëjtën faturë e kishte përmirësuar vëllai i tij [REDAKTUAR], po ashtu dëshmitari ka dhënë edhe një deklaratë plotësuese ku ka deklaruar se vërteta e ngjarjes qëndron në faktin se ditën kritike tani i akuzuari është furnizuar me derivate të naftës në pompën e benzinës [REDAKTUAR] pa dijen e policeve me rastin e furnizimit të veturës me derivate, është shënuar sasia prej 55 litrave, dhe pse në atë rast në rezervarin e veturës janë mbushur vetëm 4-5 litra e që shuma e diferencës në të holla e ka përvetësuar me qëllim të përfitimit të tij personal.

Nga dëshmia e dëshmitarit [REDAKTUAR] është vërtetuar se i njëjti është punonjës në Stacionin Policor në shtime gjatë muajit Janar 2012, me policin [REDAKTUAR] ka qenë në

ekip ne njesin e hetimeve dhe kane punuar se bashku, i kujtohet se ne fund te muajit Janar ka qene i angazhuar ne nje plan operativ dhe kane pas enje veture civile dhe orari i planit operativ ka qene nga ora 19:00 deri ne 03:00 te mengjesit, veturen zakonisht e ka vozitur [REDACTED] ashtu qe qdo dite ne baza ditore japin raport per kilometrat e kaluar poashtu i kujtohet qe edhe gjate muajit Janar kane pasur nje veture zyrtare me targa civile "[REDACTED]" me targa 05 numrat nuk i kujtohen vetem shkronjat [REDACTED] ne fund te tabelave. I kujtohet se ditën kritike jan ndaldikunrreth orës 21-22 e kanë mbush veturë me karburante dhe se [REDACTED] e ka vozitur veturën dhe i ka dhanë shënimet dhe e ka nënshkruar frakturën ku tek pompa është një zyrë ku shkohet dhe plotësohet fatura, pastaj ka deklaruar se i njuh punëtorët e pompës së benzinës si figura por jo edhe me emra me tej ka shtuar se për gabimet në faktuarë është njoftuar pas pas 3-4 dite nga [REDACTED] i cili i kishte thënë se e kishte thirre komandanti dhe i kishte treguar për gabimet në frakturë ashtu që se bashku me afrimin kishin shkuar dhe e kishin përmirësuar faktuarën.

Sa i përket dëshmisë së dëshmitarit [REDACTED] është vërtetuar se i njëjti ka punuar në cilësinë e punëtorit ne pompën e benzinës "[REDACTED]" dhe orari i tij i punës ka qene 12 ore, nga ora 08:00 deri 20:00 e mbrëmjes e anasjelltas dhe se i kujtohet se e ka përmirësuar frakturën në të cilën faturë kishte gabuar vëllai i tij [REDACTED], faturën per ta përmirësuar e kishte sjelle polici [REDACTED] dhe te njëjtin e ka përmirësuar pasi kishte biseduar me pronarin e pompës se benzinës [REDACTED] pasi qe e dinte se nuk lejohen këto përmirësime, i kujtohet se në faktuarë kishte përmirësuar , numrin e targave te automjetit etj.

Sa i përket dëshmisë së këtij dëshmitari [REDACTED] është vërtetuar se është pronar i pompës së benzinës "[REDACTED]" në [REDACTED], në pikën e derivateve të naftës në fshatin [REDACTED]. I kujtohet se ne vitin 2015 në këtë pikë të derivateve të naftës ka punuar punëtori [REDACTED] po ashtu ka shtuar faktin se orari i punës ka qene 06:00 deri 23:00 por për pjesëtaret e stacionit policor ka shërbyer 24 ore ashtu që pas orarit policinë e kane shërbyer rojtaret e pompës. I kujtohet viti 2015 [REDACTED] vëllai i [REDACTED] e kishte njoftuar përmes telefonit se [REDACTED] e kishte bere një gabim gjate përpilimit te faturës dhe i njëjti i kishte thënë se mund ta përmirëson.

Kurse sa u përket dëshmisë se dëshmitarit [REDACTED] i njëjti ka deklaruar se është inxhinier i kompjuterikes dhe detyra e tij e punës janë mirëmbajtjet teknike te sistemeve të policisë se Kosovës, po ashtu ka sqaruar se sistemi GPS është instaluar per regjistrimin e të

dhënave nga GPS për menaxhimin e veturave të policisë, lëvizjet e tyre, mbushja e derivateve ,etj. I njëjti sqaron se përmbajtja e CD-se konstatohet se vetura me datën 26-27 janar 2015, ka qarkulluar dhe ka pasur shumë lëvizje dhe nga ora 22:34 është ndalur për dy minuta pastaj ka vazhduar dhe shikimi është bërë deri në ora 23:59 po ashtu gjatë dëshmisë së tij dëshmitari ka deklaruar se ka njohuri rreth sistemit GPS por nuk është i specializuar po ashtu nuk ka mundur të jepe sqarime se pse me datën 26 dhe 29 janar censorit që i referohen derivateve të naftës në sistem të njëjtë pas mbushjes së naftës njëherë here ka treguar pas një minute në rastin e dyte pas 45 minutave dëshmitari ka sqaruar se ka vërejtur që ka vonesa por nuk ka ndryshime mirëpo nuk mund ta precizoj.

Trupi gjykues gjatë vlerësimit dëshmisë së këtyre dëshmitarëve me kujdesë ka analizuar të gjitha dëshmitë dhe ka konstatuar se janë objektive, të besueshme, të sakta dhe në shumë aspekte e plotësojnë njëra-tjetrën nuk e gjet ndonjë rrethanë që do ta dëmtonte besueshmërinë e këtyre dëshmimeve për më tepër e qartëson faktin tejet të rëndësishëm se me rastin e furnizimit me naftë të veturës zyrtare të markës” [REDAKTUAR] punëtori i pompës së benzinës “ [REDAKTUAR] : [REDAKTUAR] kishte bërë gabim gjatë përpilimit të frakturës ashtu që të njëjtën fakturë e kishte përmirësuar vëllai i tij [REDAKTUAR] pas konsultimit me pronarin e Pompës së benzinës [REDAKTUAR] po ashtu dhe nga dëshmia e dëshmitarit [REDAKTUAR] i cili ka deklaruar se vetura ditën kritike është ndalur në ora 22:34 për dy minuta , po ashtu ka deklaruar se ka njohuri rreth sistemit GPS por nuk është i specializuar .

Përmes provave materiale përkatësisht nga faktuara me numër serik 510112 të datës 27 janar 2015 është konstatuar se i akuzuari ditën kritike deri sa ka qenë në detyrë zyrtare në zbatimin e një plani operativ me veturën e markës “Golf” me targa 05-215-An është ndal në pikën e karburanteve “ [REDAKTUAR] ” e cila gjendet në rrugën magjistrale Shtime –Lipjan është furnizuar me derivate të naftës që këtë fakte e vërtetojnë dëshmitarët [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] për çka i akuzuari është furnizuar me faktuarën nr.510112 të datës 27.01.2015 të cilën e ka përpiluar punëtori i pompës “ [REDAKTUAR] ” [REDAKTUAR] ashtu që të pas reagimit të të akuzuarit të njëjtën frakturë e ka përmirësuar punëtori i pompës së benzinës “ [REDAKTUAR] ” [REDAKTUAR] e që kjo provë ndërlidhet edhe me dëshminë dëshmitarëve [REDAKTUAR] dhe [REDAKTUAR] e cila ndërlidhet edhe me dëshminë e dëshmitarit [REDAKTUAR] të dhëne në shqyrtimin gjyqësor se i njëjti pas konsultimit me pronarin e pompës së benzinës “ [REDAKTUAR] ” [REDAKTUAR] i cili e kishte njoftuar përmes

telefonit se [REDACTED] kishte gabuar gjatë përpilimit të faktuarës ashtu që pasi që pronari i kishte dhënë leje për ta përmirësuar frakturën e njëti e kishte përmirësuar dhe e kishte vulosur.

Gjykata vlerëson se provat e lartshënuara janë të besueshme nga fakti se dëshmitarët [REDACTED] [REDACTED] pjesërisht nga dëshmia e dëshmitarit [REDACTED] dhe nga shikimi i video incizimi për lëvizjet e veturës sipas vlerësimit të trupit gjykues administrimit të të gjitha provave dhe fakteve nuk është provua se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar.

### 5. Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit

Gjithsesi për të bërë një analizë gjithëpërfshirëse të të gjitha provave në një proces gjyqësor është e nevojshme të vlerësohet edhe mbrojtja e të akuzuarit e cila natyrisht asnjëherë nuk duhet të vlerësohet në mënyrë fragmentare nga provat tjera dhe po ashtu edhe nga fazat tjera të procedurës penale, e që gjithsesi është e natyrshme që në rastet e tilla kur bëhet fjalë për një veprë të kësaj natyre të rëndë është pak e besueshme që nga i akuzuari të arrihet diçka më tepër rreth shtjellimit të kësaj çështje.

Por, nga mbrojtja e tij shihet se ka mohuar kryerjen e kësaj veprë penale dhe se mbrojtja e tij është e përqendruar në sqarimin se vetura ishte në përdorim gjatë detyrës zyrtare dhe është furnizuar me derivate për përdorim për nevojat zyrtare me ç'rast është ka pranuar frakturën dhe pas disa ditë është njoftuar se faktura ka qenë e përpiluar gabimisht ashtu që të njëjtën frakturë ia ka përmirësuar dhe nënshkruar punëtori i pompës së benzinës [REDACTED]

Gjykata vlerëson disa karakteristika të mbrojtjes së të akuzuarit:

- se që nga faza fillestare e mbrojtjes së tij e deri në përfundim të saj ka mohuar kryerjen e kësaj veprë penale;

- kanë qenë konsiston dhe asnjëherë nuk ka ndryshuar mbrojtjen e tij me përjashtim dhe nuanca tejet të vogla e që këto vetëm falë sqarimit më të hollësishëm të ngjarjes;

- paraqiti mbrojtje të logjikshme, të natyrshme, për më tepër mbrojtja e tij është në harmoni dhe e mbështetur me të gjitha provat tjera të prezantuara

Megjithatë edhe nga mbrojtja e të akuzuarit nuk është arritur të vërtetohen se ka qenë i implikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në kryerjen e kësaj vepre penale, për më tepër Gjykata me gjithë shtjellimin gjithëpërfshirës të provave nuk arriti të gjente pothuajse as edhe një fije të vetme të motivit që i akuzuari kishte për të kryer një vepër të tillë meqë nga dëshmia e dëshmitarëve, shikimi i video incizimit për lëvizjet e veturës për datën 26-27 janar 2015, nuk ka mundur të përcaktohet saktë se a është ndalur vetura në pompën e benzinës "██████████" ██████████

#### **6. Vlerësimi i fjalës përfundimtare të Prokurorit të Shtetit**

Prokurori i Shtetit gjatë fjalës së tij përfundimtare fillimisht ka përshkruar rrjedhën e procedurës penale nga fillimi deri në përfundim të saj dhe duke përshkruar provat materiale e që edhe vet e konstaton se nuk kanë qenë kontestues. Por, në thelb nuk ka arritur që të paraqes ndonjë provë të themeltë që do të bënte të besueshëm se i akuzuari është kryerës i kësaj vepre penale, por shumica e pretendimeve të tij kanë mbetur në suaza të supozimeve, pa arritur që ta tejkalojnë kufirin e dyshimit të arsyeshëm. Fokusi i fjalës përfundimtare mbështetet në "adutin kryesor" (dëshminë e dëshmitarëve ██████████ dhe ██████████, ██████████ i mbështetur edhe nga dëshmitari ██████████ dhe nga Eksperti ██████████ të cilat dëshmi i ka elaborur në hollësi duke përshkruar çdo pikë të tyre.

Por ti kthehemi dhe ti analizojmë më hollësisht disa nga këto pretendime:

- së pari veprimin e të akuzuarit e përshkruan në mënyrë tejet të thjeshtë dhe në vija tejet të përgjithësuara pa elaboruar hollësi dhe detaje, për më tepër e gjithë këtë veprim të tij për veprën penale përdorim i pautorizuar i pasurisë "... *prokuroria vlerëson se i pandehuri ka prezentuar një fakturë fiktive me qëllim që të përfitoi për vete dobi pasurore e për të cilin i ka ndihmuar dëshmitari ██████████ duke e lëshuar frakturën se kinse vetura e policisë është mbushur me derivate prej 55 litrave* .

Andaj nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarit, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës, kurse në



ndërlidhje të kësaj po ashtu duke pasur parasysh faktin se të gjitha argumentet që janë “*in peius*” ndaj të akuzuarit duhet të vërtetohen me siguri të plotë përkatësisht përtej dyshimit të arsyeshëm (*beyond reasonable doubt*) dhe nëse nuk arrihet një diçka e tillë duhet konsiderohen se nuk ekzistojnë kurse për argumentet që janë “*in favorem*” ndaj të akuzuarit merren se ekzistojnë edhe atëherë kur janë vërtetuar me probabilitet.

Për më tepër është e pa diskutueshme se mbi kënd bie barra e provës për fajësinë e të akuzuarit dhe çdo veprim tjetër i Gjykatës do të kuptohet si e kundërt dhe në këtë mënyrë lëvizje e barrës së provës nga organi i akuzës në të akuzuarit, e cila është në kundërshtim esencial të njërit prej parimeve fundamentale të procedurës penale e përcaktuar me nenin 7 të KPPK-së dhe e garantuar edhe me nenin 6.2 të KEDLNJ.

### **7.Kërkesa pasurore juridike dhe shpenzimet procedurale**

Konform nenit 103 par.1 të KPPK-ës, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve të kësaj Gjykate.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## **GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me PKR.nr.72/16, me datë 28.06.2017**

**Sekretarja juridike,**

**Albana Ujupi**

**Kryetari i trupit gjykues,**

**Hysnije Gashi**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj.